



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	20.03.2024
Për:	Arbëneshja Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Përmes:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Nga:	Durim Halilaj, Kryesues i Komisionit për Dhënie në Shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1
Lënda:	REKOMANDIM

Të nderuar,

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/01-21401 të datës 30.10.2023, në bazë të nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 21 dhe 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe Njoftimin Publik me numër 01-463/02-1251 të datës 29.01.2024, me datën 20.03.2024, nxjerr këtë:

REKOMANDIM

1. Komisioni Vlerësues rekomandon Kuvendin e Komunës të miratojë vendimin përfundimtar për Dhënie në Shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale, me numër të parcelës P-70705029-016371-1, ofertuesit: D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K.
2. Komisioni Vlerësues, pas vlersimit të ofertës së vetme, si dhe pas përfundimit të afatit të ankesave, oferta e përzgjedhur më e favorshme sipas kushteve të përcaktuara në Njoftimin Publik është: **D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K.**

3. Pas miratimit të vendimit përfundimtar, të autorizohet Kryetari i Komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit përfundimtar të lidhë kontratën më fituesin.
4. Pjesë përbërëse e këtij Rekomandimi është: Raporti i Vlerësimit dhe Oferta e përzgjedhur.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/01-21401 të datës 30.10.2023, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenin 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujatshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01-020-37472 të datës 27.07.2016, të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës komunale, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.01.2024 merr vendim për shpalljen e:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së palujatshme komunale me numër të parceles P-70705029-016371-1

Me të cilin ftohen të gjithë të interesuarit, që të shfrytëzojnë të drejtën e marrjes në shfrytëzim të pronës së palujatshme komunale:

1. **Prona e palujatshme për dhënien në shfrytëzim gjendet:** në zonën kadastrale Gjakovë - Qytet, e evidentuar me numër kadastral të ngastrës: P-70705029-016371-1.
2. **Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës:**

Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujatshme komunale do të jetë afatgjatë, deri nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

Qëllimi:

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë është:

1. Funksionalizimi i pronës;
2. Ndërtimi i objektit me destinim – objekt banimi shumë banesor me afarizëm, siç përcaktohet me dokumentet e planifikimit hapësinor.

Kriteret për zgjedhjen e ofertave:

Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së palujatshme të komunës, bazohet në ofertën ekonomikisht më të favorshme që përfshinë:

- a) Çmimi fillestar 30% e vlerës apo metër katror të ndërtimit në interes të Komunës, sipërfaqja e të cilës do ti takoj Komunës për çdo etazh - **(vlerësohet nga 0 – 50 pikë);**
- b) Plani dinamik i realizimit të investimit – ndërtimit - **(vlerësohet nga 0 – 20 pikë);**
- c) Numri i të punësuarve - **(vlerësohet nga 0 – 10 pikë);**
- d) Qarkullimi bankar për tri (3) vitet paraprake - **(vlerësohet nga 0 – 10 pikë).**
- e) Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë, ose qasje në kredi të pakushtëzuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia - **(vlerësohet nga 0 – 10 pikë).**

Në rast se në ankand ofrohen dy apo me tepër oferta të njëjta, atëherë përfituesi caktohet me short ndërmjet këtyre ofertave, në prani të tyre dhe të Komisionit Vlerësues.

Kushtet e përgjithshme të ankandit publik:

1. **Personat juridik** të cilët marrin pjesë në këtë procedurë, ofertës duhet bashkangjitur këto dokumentacione:
 - **Certifikatën e regjistrimit të biznesit – Veprimtaria ndërtim i lartë;**
 - **Vërtetimin e ATK-së mbi kryerjen e obligimeve tatimore;**
 - **Vërtetimin e tatimit në pronë;**
 - **Vërtetimin e taksës në firmë;**
 - **Pasqyrat financiare të audituara dhe qarkullimin bankar së paku tre (3) milion euro, në tri (3) vite të fundit;**
 - **Plani dinamik i realizimit të investimit – ndërtimit;**
 - **Dëshmi – certifikatën e përdorimit të lëshuar nga organi komunal për objekte e larta së paku dy (2) copë për tri (3) vitet të fundit;**
 - **Vërtetimin e gjykatës kompetente që operatori ekonomik nuk është në falimentim, ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor;**
 - **Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari në vlerë prej 400.000,00 euro, ose qasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni;**
 - **Deklarata nën betim të nënshkruar dhe vulosur nga aplikuesi.**
2. Ofertuesit që nuk i bashkëngjisin të gjitha dokumentet e nevojshme, diskualifikohen dhe oferta e tyre nuk do të shqyrtohet fare.
3. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb – faqe të Komunës dhe në vendet publike. **Ofertat** me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen të mbyllura (në pliko) në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimi, kati përddhesë, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë, nga data **29.01.2024** deri me datë **12.02.2024** në orën 15:00h dhe të protokollohen nga Komuna.

4. **Vendi dhe koha ku do të mbahet ankandi publik:** Objekti i Komunës së Gjakovës, Rruga "UÇK" (ish objekti i Bankosit), kati IV, salla e asamblesë komunale, me datën **15.02.2024** në fillim të orës 10:00 h, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe të njëjtat do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.
5. **Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik:** Të informohen me procedurat e ankandit publik, të shohin pronën që jepet në shfrytëzim, të kenë qasje në dokumentacionet e pronës dhe të tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik.
6. Procedurat e ankandit mund të zhvillohen edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara.
7. **Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:** Komisioni Vlerësues brenda tre (3) ditë pune pas mbylljes së njoftimit publik, fton për hapjen e ankandit dhe vlerësimin e ofertave. Kryesuesi i komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e komisionit, në prani të ofertuesve, bën hapjen e ofertave ku identifikohen të gjitha ofertat e aplikuesve. Pas vlerësimit të ofertave në ankand publik, Komisioni vlerësues harton raportin përfundimtar dhe përzgjedh ofertën më të favorshme. Njoftimi për ofertën e përzgjedhur i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike dhe në web-faqen zyrtare të komunës.
8. Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë "*Komisionit për ankesa*" në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb – faqen e Komunës.
9. Nëse komisioni i ankesave vlerëson ankesat si të pabazuara, raporti i vlerësimit së bashku me ofertën e përzgjedhur i dërgohet kuvendit të komunës për miratim. Kuvendi miraton vendimin përfundimtar.
10. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës nënshkruhet nga kryetari i komunës i cili përfaqëson komunën dhe nga fituesi i përzgjedhur, me anë të së cilës përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.



Halil Halilaj

Kryesuesi i Komisionit Vlerësues



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70705029-01637-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 13/24
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 24.01.2024 - 08:56
Komuna / Opština / Municipality: GJAKOVË / DJAKOVICA / GJAKOVË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gjakovë-Qyteti / Gjakovë-Qyteti / Gjakovë-Qyteti
Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: GJAKOVË / DJAKOVICA / GJAKOVË

TE DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70705029-01637-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Urban	356	261/10-Ndarje fizike;Aktgjykimi C.nr.416/06;dt.07.12.09;Gjyk.Kom.Gjakovë		

1. ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Qytet				



2. LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri broj number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvorište/Back Yard		253
2	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Shëpi-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		103

PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
sedim individual / lividualna Drzavina / igle possessor	Komuna e Gjakovës	600597986	/ / /		NËNA TEREZË	1/1	261/10-Ndarje fizike;Aktgrykitimi C.nr.416/06;dt.07.12.09;Gjyk.K om.Gjakovë	





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT \ KOPIJA PLANA \ COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija \ Municipal Cadastral Office : **GJAKOVË**
Zona Kadastrale / Katastarska Zona \ Cadastral Zone : **Gjakove Qytet**

Njësia \ Jedinica \ Unit	Tipi \ Vrsta \ Type	Sipërfaqja \ Poveršina \ Area m²
P-70705029-01637-1	Parcele	356

1637-1

1637-7

Rruge


Shkalla / Razmera /Scale: 1:500

Punoi \ Obradio \ Created :
Data \ Data \ Date : 24.01.2024
Koha \ Vreme \ Time : 10:00:09
Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:
Shënim \ Beleşka \ Note :

Approvuar / Odobreno / Approved : Drejtori \ Direktor \ Director

Nënshkrimi \ Potpis \ Signature:





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E GJAKOVËS



OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës – Gjakovë

01 Nr. /2023

Dt. 26.10.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nënim 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 nr.011/04-29365 i datës 30.12.2022, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunalet, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.10.2023 pas diskutimit lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Shqyrtimi i propozimit vendimit për formimin e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale sipas vendimit 01 nr.020-37472, e miratoi këtë:

V E N D I M

- Formohet Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelës 16371/I sipas vendimit 01nr.020-37472 të datës 21.07.2016 me këtë përbërje:
 - z. Durim Halilaj, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
 - z. Kosovar Alija, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
 - z. Himë Zeqa, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
 - zgj. Mimoza Shala, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
 - zgj. Erblina Dinarama, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar.
- Ky komisioni vlerësues ka për detyrë dhe përgjegjësi që të zhvilloj procedurat e parapara me ligjin për Dhënie në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale të përshkruar në pikën 1 të këtij vendimi.
- Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me numër 01-011/01-3514 i datës 10.02.2022.
- Ky vendim hyr në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
- Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës,
 - Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal,
 - Anëtarëve të Komisioni Vlerësues,
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës,
 - Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë

01 Nr. _____/2016

Dt. 21.07.2016

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 6.2, nenin 7.2. dhe 7.3 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, nenit 11.1 dhe 11.2 të Rregullores së QKR-së nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, pas diskutimit lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës: Shqyrtimi i rekomandimit të MAPL-së, lidhur me vendimin 01nr.011-23746/2016 të dt.26.04.2016 për iniciimin e procedurave për Shpalljen e Ankandit Publik në Pronën Komunale me nr. 1637/1, e miratoi këtë:

V E N D I M

Paraprak

për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës Komunale

1. Miratohet kërkesa për iniciimin e procedurës për shpalljen e Konkursit të hapur publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë, të parcelës kadastrale ndërtimore me numër 1637/1 Z.K Gjakovë qytet në pronësi Komunale.
2. Prona e përshkruar në pikën e parë të këtij vendimi do të ipet në shfrytëzim me qëllim të ndërtimit të objektit me destinim objekt banimi shumë banesor me afarizëm në përdhese me etazhitet 2B+P+3+NK i planifikuar me Zgjidhjen Urbanistike të kompleksit " vazhdimi i qendrës së ngushtë të qytetit prej Hotel Pashtrikut e deri tek rruga Mazllom Lakuci" segmenti nga Xhamia e re deri tek rruga Mazllom Lakuci i miratuar në sesionin e VII të Kuvendin Komunal të Gjakovës i mbajtur me datë 14.03.2001.
3. Dhënja në shfrytëzim e pronës së përshkruar në pikën 1 të këtij Vendimi përmes konkursit të hapur Publik do të shfrytëzohet për kompenzimin e pronave – paluejtshmëritë në pronësi të personave fizik e të cilat janë shpallur Interes Publik për realizimin e projekteve me interes për qytetin e Gjakovës .

4. Parcela – paluejtshmeria nga pika 1 e këtij Vendimi i referohet të dhënave kadastrale respektivisht Certifikatës mbi pronën me numër 7-27185, njësia kadastrale P-70705029-01637-1 e cila evidentohet në posedim të P.SH.Kuvendi i Komunës Gjakovë në sipërfaqe prej 0.03.56 ha me kulturë: oborr në sipërfaqe prej 0.02.53 ha dhe shtëpi në sipërfaqe prej 0.01.03 ha.
5. Autorizohen organet e Administratës Komunale që ti zhvillojnë të gjitha procedurat e parapara ligjore për realizimin e këtij Vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës .
- 7. Vendimi iu dërgohet:**
- Znj. Mimoza Kusari- Lila, Kryetare e Komunës së Gjakovës
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës,
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë,
 - Arkivit,



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Z. Lila
Gola

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES

Nr. Inv/Br. Inv. 14-463/17-2238
Data/Datum/Date 15.02.2024
Gjakovë - Djakovica - Gjakova



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë 15.02.2024

Gjakovë

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/01-21401 të datës 30.10.2023, duke u bazuar në nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujatshme të Komunës, nenit 12 të Rregullore (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujatshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01-020-37472 të datës 27.07.2016 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës komunale, si dhe Njoftimit Publik me numër 01-463/02-1251 të datës 29.01.2024, në mbledhjen e mbajtur me datën 15.02.2024, komisioni bie këtë:

Njoftim për shpalljen e fituesit të Njoftimit Publik për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së palujatshme komunale me numër të parceles P-70705029-016371-1

Pas vlerësimit të ofertës së vetme në njoftimin publik, komisioni ka përzgjedhur të njëjtën si oferta ekonomikisht me e favorshme në ankand publik.

I përzgjedhuri është: D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike dhe në web-faqen zyrtare të komunës.

Këshilla Juridike: Palët e pakënaqura me vlerësimin e komisionit, kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë pranë “Komisionit për ankesa” në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb – faqen e Komunës.



Durim Halilaj

Kryesues i Komisionit Vlerësues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë 15.02.2024

Gjakovë

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/01-21401 të datës 30.10.2023, duke u bazuar në nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 12 të Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01-020-37472 të datës 27.07.2016 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, si dhe Njoftimit Publik me numër 01-463/02-1251 të datës 29.01.2024, në mbledhjen e mbajtur me datën 15.02.2024, komisioni bie këtë:

Raport Përfundimtar për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme

Komisioni Vlerësues i themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/01-21401 të datës 30.10.2023, me datën 29.01.2024, pas dy (2) mbledhjeve ka nxjerrë Njoftimin Publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1.

Afati për paraqitjen e ofertave në Njoftimin Publik ka qenë nga data 29.01.2024 deri me datë 12.02.2024, në këtë procedurë është pranuar vetëm një (1) ofertë nga partnerët e bashkëpunimit “D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K”.

Me datë 15.02.2024, me fillim nga ora 10:00h, Kryesuesi i komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e komisionit, bën hapjen e ofertës, duke bërë vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur në ofertë sipas kushteve të paracaktuara në Njoftimin Publik. Komisioni pas shqyrtimit të ofertës ka përzgjedhur të njëjtën si oferta ekonomikisht me e favorshme në këtë procedurë.

Komisioni Vlerësues pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit të paraqitur në ofertë nga i vetmi ofertues, duke u bazuar në kërkesat e Njoftimit Publik në mënyrë unanime voton që të përzgjedhë si fituese të ofertës së këtij njoftimi publik: “D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K”.

Pas përfundimit të afatit të ankesave, raporti i vlerësimit së bashku me ofertën e përzgjedhur i dërgohet kuvendit të komunës për miratim.

Në emër të Komisionit:

Durim Halilaj, Kryesues





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komision Vlerësues
Dt. 15.02.2024
Gjakovë

PROCESVERBAL

I përpiluar nga Komisioni Vlerësues me datën **15.02.2024**, duke filluar në ora **10:00**, në zyrën nr. 8 kati I në ndërtesën e ish Bankosit - Komunës së Gjakovës, i përbërë nga Durim Halilaj, Kosovar Aliju, Himë Zeqa, Mimoza Shala dhe Erblina Dinarama anëtarë, procesmbajtës Florent Koci, për zhvillimin e procedurës së dhënien në shfrytëzim të pronës së pajtueshme komunale – parcela 1637/1, sipas vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës së Gjakovës me numër 01-020-37472 të datës 21.07.2016, si dhe Njoftimin Publik me numër 01-463/02-1251 të datës 29.01.2024.

Filloj në ora 10:00

Prezent janë:

Anëtarët e Komisionit:

1. Durim Halilaj, kryesues
2. Kosovar Aliju, anëtar
3. Himë Zeqa, anëtar
4. Mimoza Shala, anëtare
5. Erblina Dinarama, anëtare

Çështjet që u diskutuan:

- Shqyrtimi i ofertave.

Kryesuesi i komisionit fillimisht njoftoj të pranishmit për procedurat e hapjes së ofertave dhe të drejtat e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Kryesuesi i komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e komisionit, bënë hapjen e ofertave.


Në këtë procedurë kanë marrë pjese një (1) ofertues, përkatësisht: **D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K**

Bashkangjitur në këtë procesverbal është edhe lista me kushtet të veçanta dhe të përgjithshme të ankandit public, si dhe formulari i vlerësimit.

Autorizohet kryesuesi i Komisionit vazhdojë me procedurat e njoftimit për ofertën me të favorshme sipas formularit të vlerësimit, po ashtu pas kalimit të afatit të ankesave të paraqes në Kuvendin Komunal rekomandimin për ofertën me të favorshme.

Përfundoj në ora 12:00

Procesmbajtës


Florent Koci

Anëtarët e Komisionit


Durim Halilaj




Kosovar Aliju


Himë Zeqa


Mimoza Shala


Erblina Dinarama



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kushtet e veçanta dhe kushtet e përgjithshme të ankandit publik për pronën e palujatshme komunale me numër të parces P-70705029-016371-1.

Nr.	Emri dhe Mbiemri i ofertuesit	Person Juridik	Mungesat e dokumentacionit
1.	D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K	1. Certifikatën; 2. Vërtetimin e ATK; 3. Vërtetimin e tatimit në pronë; 4. Vërtetimin e taksës në firmë; 5. Pasqyrat financiare të audituara dhe qarkullimin bankar së paku tre (3) milion euro, në tri (3) vite të fundit; 6. Plani dinamik i realizimit të investimit – ndërtimit; 7. Dëshmi – certifikatën e përdorimit të lëshuar nga organi komunal për objekte e larta së paku dy (2) copë për tri (3) vitet të fundit; 8. Vërtetimi i Gjykatës; 9. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari në vlerë prej 400.000,00 euro, ose qasje në kredi të pakushtëzuar, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni; 10. Deklarata nën betim të nënshkruar dhe vulosur nga aplikuesi.	1. + 2. + 3. + 4. + 5. + 6. + 7. + 8. + 9. + 11. +

Nënshkruar nga anëtarët prezent të Komisionit:

Kryesuesi _____

Anëtarja _____

Anëtari _____

Anëtarja _____

Anëtari _____

Datë: 15.02.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Dt. 15.02.2024

Formulari i vlerësimit të Njoftimit për Ankand Publik për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së palujatshme komunale me numër të parces P-70705029-016371-1.

Ofertuesi: D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K

Nr.	Kriteret për zgjedhjen e ofertes	Pikët
1.	Çmimi fillestar 30% e vlerës apo metër katror të ndërtimit në interes të Komunës, sipërfaqja e të cilës do ti takoj Komunës për çdo etazh - (vlerësohet nga 0 – 50 pikë);	50
2.	Plani dinamik i realizimit të investimit – ndërtimit - (vlerësohet nga 0 – 20 pikë);	20
3.	Numri i të punësuarve - (vlerësohet nga 0 – 10 pikë)	10
4.	Qarkullimi bankar për tri (3) vitet paraprake - (vlerësohet nga 0 – 10 pikë)	10
5	Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë, ose qasje në kredi të pa kushtëzuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia - (vlerësohet nga 0 – 10 pikë)	10

Anëtarët e Komisionit:


Durim Halilaj

Mimoza Shala


Kosovar Aliju

Erblina Dinarama


Himë Zeqa





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr. 079/01-2942
Dt: 27.02.2024

Komisioni për shqyrtimin e Ankesave në Procedurën e Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në përbërje: Gjevalin Nikollbibaj kryesues, Eranda Kumnova – Baçi, Valon Pnishi, Liridon Dula dhe Nora Kulludra anëtar, duke vepruar konform dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, duke vendosur lidhur me ankesën e N.T.SH. “G.B. – Construction” dhe “Ylli Pashtriku” SH.P.K, me numër 01-070/01-2536 të datës 21.02.2024, në mbledhjen e mbajtur me datën 27.02.2024, nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e N.T.SH. “G.B. – Construction” dhe “Ylli Pashtriku” SH.P.K, me numër 01-070/01-2536 të datës 21.02.2024.
2. Mbetet në fuqi njoftimi për shpalljen e fituesit me numër 01-463/01-2278, të datës 15.02.2024.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Komisionit.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës përkatësisht Komisioni Vlerësues me datën 29.01.2024 ka nxjerrë Njoftim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale me numër të parces P-70705029-016371-1. Në këtë procedurë është pranuar vetëm një ofertë, e cila ofertë është për zgjedhur si fituese nga Komisioni Vlerësues.

Kundër Njoftimit për shpalljen e fituesit të Njoftimit Publik, pala e interesit ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurave administrative, Vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe Aplikimin e gabuar të dispozitave materiale.

Ankuesi përmes ankesës ka kërkuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave që të bëjë anulimin e Njoftimit me numër 01-463/01-2278 të datës 15.02.2024, me pretendimin e përshkruar në ankesë

lidhur me rrjedhen e procedurës paraprake të Njotimit Publik të datë 29.03.2022, që ka të bëjë me të njejtën pronë komunale, që gjendet në procedurën e dhënies në shfrytëzim.

Në ankesë është përshkruar se çështja e Njoftimit Publik të datës 29.02.2022, gjendet në procedurën gjyqësore në Gjykatën Komerciale.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave, ka analizuar dhe ka vlerësuar me kujdes pretendimet e ankuesit secilën veç e veç dhe ka arritur në përfundim se ankesa është e pabazuar dhe si e tillë **refuzohet**, për shkak se:

Ankuesi me datën 29.01.2024, ka parashtruar në Gjykatën Komerciale kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të Njoftimit Publik me numër 01-463/01-1251 të datës 29.01.2024, ku Gjykata këtë kërkesë e kishte hudhur poshtë si të pa lejuar me datën 12.02.2024.

Komisioni i Ankesave, pasi konstaton se procedura gjyqësore nuk e ndalon procesin e veprimeve për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale siç përcaktohet në nenin 22 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, si citoj: *Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.*

Komisioni poashtu, vlerësoi faktin se në Njoftimin paraprak të vitit 2022, nuk është shpallur ndonjë fitues, si dhe në këtë proces nuk është paraqitur oferta nga pala ankuese me çka i jep legjitimitet procedurës për të vazhduar tutje, në këtë rast Komisioni konstaton që nuk është e nevojshme të bëhet shqyrtimi i ofertes fituese, pasi që ankese nuk e ka natyrën goditjes së procedurës së vlersimit të këtij njoftimi.

Nga se u cek më lartë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilla juridike: kundër vendimit të Komisionit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Komisionit Vlerësues
- Palës
- Arkivit.



Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës • Opština Gjakovica • Municipality of Gjakova

ARKIVA HYRËSE
UVODNI ARHIV
INTRODUCTORY ARCHIVES

IV/1

Njëzia O.I.D./J.O.I. 01 Numër/Br./No. 070/01 Nr. fageve/Str./No. 2536

Data/Datum/Date 21.02 Pranoj/Prihvati/Accept 2024

Gjakovë - Gjakovica - Gjakova

Lidhja: 01 nr. 463/01 -2278

KOMUNËS SË GJAKOVËS

për

KOMISIONIT TË ANKESAVE

N.T.SH. “G.B.-Construction” me seli në Gjakovë dhe

“Ylli Pashtriku” sh.p.k. me seli në Gjakovë, konfrom nenit 20 të Ligji nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.10/03 prill 2019, paraqet këtë:

ANKESË

ndaj

NJOFTIMIT 01.nr.463/01-2278 të dt. 15.02.2024

- *Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative,*
- *Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike,*
- *Aplikimin e gabuar të dispozitave materiale,*

Komisionit të Ankesave si organ i shkallës së dytë i propozoj që të bie Aktvendim, me të cilin:

- **ANULOHET** Vendimi në formë të NJOFTIMIT 01.nr.463/01-2278 i dt. 15.02.2024 për shpalljen e fituesit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1,


paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1, i atakuar me këtë ankesë, janë shpallur fituesit në ankandin e ri publik.

8. Konsideroj që njoftimi i atakuar me këtë ankesë cenon rëndë të drejtat themelore të parashtrësve të ankesës dhe se me dhënien në shfrytëzim të paluajtshmërisë lëndore subjekteve të treta, parashtruesve të ankesës do të ju shkaktohet dëm i madh dhe i pariparueshëm.
9. Përfundimisht, Komisionit të Ankesave i propozoj që këtë ankesë të e aprovoj sit ë bazuar, ashtu që të anulohet, Vendimi në formë të NJOFTIMIT 01.nr.463/01-2278 i dt. 15.02.2024 për shpalljen e fituesit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-016371-1.

Gjakovë, 21.02.2024

Parashtruesi i Ankesës

NITSH GB CONSTRUCTION
044 127 163



YLLI PASHTRIK



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES

Nr. Inv/Bc/Inv 01-463/11-2238
Data/Datum/Data 15.02.2024
Gjakovë - Djakovica - Gjakova



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Datë 15.02.2024
Gjakovë

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-011/01-21401 të datës 30.10.2023, duke u bazuar në nenit 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujatshme të Komunës, nenit 12 të Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujatshme të Komunës, me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01-020-37472 të datës 27.07.2016 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës komunale, si dhe Njoftimit Publik me numër 01-463/02-1251 të datës 29.01.2024, në mbledhjen e mbajtur me datën 15.02.2024, komisioni bie këtë:

Njoftim për shpalljen e fituesit të Njoftimit Publik për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite të pronës së palujatshme komunale me numër të parceles P-70705029-016371-1

Pas vlerësimit të ofertës së vetme në njoftimin publik, komisioni ka përzgjedhur të njëjtën si oferta ekonomikisht më e favorshme në ankand publik.

I përzgjedhuri është: D&T Group SH.P.K, OSMANI CONSTRUCTION SH.P.K dhe KAN GROUP SH.P.K.

Njoftimi për ofertën e përzgjedhur i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike dhe në web-faqen zyrtare të komunës.

Këshilla Juridike: Palët e pakënaqura me vlerësimin e komisionit, kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë pranë "Komisionit për ankesa" në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes së njoftimit në ueb - faqen e Komunës.

